**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"G&M HOLDING SHPK" sh.p.k**

**PJESA E PARE**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Ortaket e Shoqerise**

Shoqeria **"G&M HOLDING SHPK** " sh.p.k perbehet nga 1 ortake, eshte:

1. **Z. Murat Gjeladini**, shtetas kosovar i datelindjes **11/04/1985**, i lindur ne Peje dhe banues ne Tirane, identifikuar nga pasaporta **nr.P00175825** dhe **nr.personal 1170170233**, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Neni 2**

**Emri i Shoqerise**

**2.1** Emri i shoqerise eshte **"G&M HOLDING SHPK**" sh.p.k e cila, ne tekstin e ketij Statuti do te quhet "Shoqeria**".**

**2.2** Emri i shoqerise, administratorit si dhe vula e shoqerise duhet te figurojne ne te gjitha shkresat zyrtare te shoqerise si dhe dokumenta qe kane te bejne me permbushjen e objektit, apo qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit te saj. Shoqeria **"G&M HOLDING SHPK**" sh.p.k ka vulen e saj

**Neni 3**

**Selia e Shoqerise**

**3.1** Shoqeria e ka seline ne adresen : Rr. Hamid Shijaku, pallati i ri h.1, shkalla 2 nr.9, Njesia Bashkiake, Tirane

**3.2** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijoje brenda Republikes se Shqiperise ose jashte saj, dege dhe /ose zyra perfaqesimi.

**3.3** Selia e Shqiperise mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te Asamblese se Shoqerise

**Neni 4**

**Forma ligjore**

**4.1** Forma ligjore e Shoqerise eshte "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" (SHPK)

**4.2** Shoqeria eshte person juridik shqiptar e cila me miratimin e ketij Statuti, e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe kete Statut.

**Neni 5**

**Kohezgjatja**

**5.1** Shoqeria zvillollon aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.

**5.2** Asambleja e pergjithshme e Shoqerise mund te percaktoje nje afat per perfundimin e veprimtarise se shoqerise dhe prishjen e saj.

**Neni 6**

**Objekt i veprimtarise**

**6.1** Objekt i veprimtarise konsiston ne :

a. Import-Eksport, tregti me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore, pije alkoolike dhe industrial

b. Prodhim dhe paketim te produkteve industrial.

c. Shoqeria mund te marre pjese ne sipermarrje te tjera apo te themeloje te tilla.

d. Investime ne fushen tregtare , kulturore, sportive, te veprave te kultit, te objekteve sociale, hoteleve, fshatrave turistike, etj.

e. Sherbime te ndryshme, ne favor te te treteve, si konsulenca, sherbime ne fushen administrative , kontrollit sasior dhe cilesor te mallrave.

f. Spedicion te mallrave te import-exportit, tranzite ne territorin e Republikes se Shqiperise

g. Shoqeria pervec sa me siper , mund te shese , te bleje dhe te marre pjese ne formen e aksioneve ose jo edhe ne te tjera shoqeri vendase ose te huaja, te cilat kane objekt te njejte veprimtarie ose te ngjashme me te.

h. Dhenie me qira te treteve, makineri, paisje, mjete transporti etj.

i. Import-eksport i te gjitha llojeve te mallrave industrial e ushqimore, i makinerive qe sherbejne ne fushen e prodhimit te brumrave.

j. Prodhim i makaronave dhe i brumrave si dhe tregetimi I tyre me shumice dhe pakice . Aktivitet ekonomik ne fushen e agrobiznesit.

**6.2** Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk ndalohet nga legjislacioni ne fuqi

## PJESA II

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE DHE KUOTAT

### Neni 7

### Kapitali i Shoqerise

**7.1** Kapitali themeltar i Shoqerise eshte **7,000,000 ALL**

**7.2** Kapitali themeltar ndahet ne 1 pjese , perkatesisht:

- **Z.Murat Gjeladini, 1 Kuota (7,000,000 ALL)**

**7.3** Kapitali i shoqerise nuk eshte shlyer prej ortakeve te shoqerise, ai mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortaket, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

### Neni 8

### Transferimi i kuotave

**8.1** Kuotat e kapitalit jane te transferueshme nga ortaket tek personat e trete vetem me miratim me shkrim nga Asambleja e Ortakeve.

**8.2** Kuotat e kapitalit te shoqerise jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

**8.3** Kuotat e kapitalit te shoqerise mundet te transferohen lirisht midis prindit dhe femijes ose anasjelltas.

## PJESA III

## Te Drejtat dhe Detyrimet e Ortakeve

### Neni 9

### Pergjegjesia e kufizuar

Ortaket jane pergjegjes deri ne vleren e pjeses se pashlyer te kontributeve te nenshkruara ne kapitalin e Shoqerise. Shoqeria eshte pergjegjese per detyrimet e saj.

### Neni 10

### E drejta e pjesemarrjes ne mbledhjet e Asamblese

Ortaket e shoqerise kane te drejte te marrin pjese ne mbledhjet e shoqerise personalisht ose me prokure, te informohen mbi ceshtjet e Shoqerise si dhe te inspektojne dhe kontrollojne librat dhe regjistrat e Shoqerise.

## PJESA IV

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

### Neni 11

### Te drejtat e Asamblese se pergjithshme

**11.1** Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise e cila ka te drejte te marre vendime ne lidhje me te gjitha ceshtjet e veprimtarise se saj.

**11.2** Te drejtat e Asamblese se Pergjithshme ushtrohen nga Ortaket e shoqerise.

**11.3** Asambleja e pergjithshme, pervec sa parashikohet ne dispozita te vecanta te Ligjit apo Statutit, ushtron ne menyre ekskluzive te drejtat dhe kompetencat e meposhtme:

a. Ndryshimet e Statutit,
b. Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te Shoqerise,
c. Perdorimin e fitimit per shperndarje tek ortaku, investim ne Shoqeri dhe/ose forma te tjera perdorimi qe ortaku do t'i gjykoje te pershtatshme,
d. Bashkimin, ndarjen ,riorganizimin, prishjen, dhe cdo lloj transformimi te Shoqerise,
e. Pranimin e ortakeve te rinj (pas rritjes se kapitalit apo transferimit te kuotave),
f. Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
g. Blerjen dhe disponimin e interest pjesemarres ne shoqeri shqiptare apo te huaja,
h. Miratimi e raporteve vjetore dhe bilancit te shoqerise,
i. Ngritjen e padive kunder administratoreve te Shoqerise, si dhe caktimin e perfaqesuesve ligjore perkates,
j. Blerjen, dhe shitjen e pasurive te paluajtshme,
k. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese,
l. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
m. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitijen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,

n. Percaktimin e structures organizative dhe administrative te shoqerise,
o. Miratimin e rregullave te brendshme mbi administrimin dhe funksionimin e shoqerise,
p. Emerimin dhe/ose shkarkimin e administratoreve,
q. Emerimin dhe/ose shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
r. Caktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertin kontabel te autorizuar,
s. Marrjen e huave ne emer te Shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase duke perfshire vendosjen e aseteve te luajtshme dhe te paluajtshme te shoqerise si mjete per garantimin e huave ne forme hipoteke, pengu,barre, etj.,
t. Miratimin e cdo ceshtjeje tjeter zgjidhjae se ciles i eshte rezervuar Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me ligjin dhe kete Statut.

**11.4** Asambleja e pergjithshme ka kompetenca diskreciale per te ne gjitha vendimmarrjet e Shoqerise dhe qe nuk lidhen me administrimin e saj. Ne kuptim te kesaj dispozite, Asambleja e pergjithshme mund te vendose ne lidhje me ceshtjet te cilat ligji dhe Statuti nuk ia njohin ne menyre te shpreshur Administratorit , me kushtet qe:

a. Keto veprime te lidhen vetem me kompetencat e vendimmarrjes dhe jo te administrimit,
b. Keto veprime te synojne "**G&M HOLDING SHPK"** lizimin e objektit te Shoqerise,
c. Keto veprime te jene dhe te kryhen ne menyre te ligjshme.

**Neni 12**

**Thirrja e Asamblese se Pergjithshme**

**12.1** Asambleja e pergjithshme do te mblidhet te pakten nje here ne vit ne seline e shoqerise, ne vendin ku kryhet veprimtaria kryesore administruese e shoqerise,ose ne ndonje vend tjeter te propozuar nga Administratori/Administratoret ne konsultim me ortakun e shoqerise.

**12.2** Asambleja e pergjithshme do te thirret me ane te nje njoftimi te derguar nga Administratori/Administratoret, njoftim ky i cili mund te merret nga ortaku ose perfaqesuesi /t

i/e tij jo me vone se 7 (shtate) dite kalendarike perpara dates se caktuar te mbledhjes. Ftesa do te regjistrohet ne librin e procesverbalit te Shoqerise.

**12.3** Ftesa per mbledhjen e Asamblese se pergjithshme do te tregoje daten, oren, vendin e mbledhjes si dhe ceshtjet e rendit te dites.

**12.4** Nese data pe rmbledhjen e ardhshme te Asamblese eshte vendosur ne takimin e fundit ku te gjithe ortaket kane qene prezent te pranishem, atehere njoftimi presupozuhet se eshte kryer rregullisht.

**Neni 13**

**Vendimet e marra ne Asamblene e Pergjithshme**

**13.1** Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime edhe ne mungese te ortakut te vetem nese ai perfaqesohet me prokure.

**13.2** Prokura duhet te jete e noterizuar dhe te paraqitet ne mbledhjen e Asamblese se pergjithshme. Prokura depozitohet se bashku me dokumentacionin e mbledhjes perkatese dhe kur kjo nuk eshte e mundur, ne vend te saj duhet te depozitohet nje kopje e njesuar me origjinalin nga nje noter. Prokura duhet te jete ne gjuhen shqipe ose ne ndonje gjuhe tjeter te kuptueshme nga te gjithe ortaket e pranishem dhe pjesemarresit e tjere ne mbledhje. Ne cdo rast, te dhenat kryesore te prokures, perfshire edhe targat e perfaqesimit, fiksohen edhe ne procesverbalin e mbledhjes.

**13.3** Vendimet e Asamblese se pergjithshme mund te merren dhe pa pjesemarrjen fizike te ortakut , por ne keto raste duhet te aplikohet nje nga format e komunikimit ne kohe" **G&M HOLDING SHPK"** - sikurse jane, por pa u kufizuar vetem ne to, telekonferenca, video konferenca, komunikimi online VOIP (Voice Over IP) dhe te tjera menyra te ngjashme- nese te gjithe ortaket kane dhene pelqimin e tyre paraprak ne fillimin e mbledhjes dhe identiteti i ortakeve mund te percaktohet pa dyshim. Ne rast te aplikimit te kesaj dispozite, forma dhe mjetet e komunikimit , qendrueshmeria e tij gjate mbledhjes, si dhe cdo defekt i mundshem, duhet te fiksohet ne procesverbalin e mbledhjes.

## Neni 14

## Drejtimi i mbledhjes se Asamblese dhe marrja e vendimeve

**14.1** Mbledhja e Asamblese si rregull drejtohet nga ortaket

**14.2** Ne fillim te mbledhjes caktohet nje sekretar i cili mban procesverbalin e mbledhjes dhe fikson te dhenat kryesore dhe vendimet qe merren prej saj

**14.3** Ne rast thirrjeje te mbledhjes se Asamblese nga administrator ose likuiduesi/it ajo drejtohet nga personi ose njeri prej personave qe kane thirrur mbledhjen .

**14.4** Ne fillim te mbledhjes verifikohet pjesemarrja e ortakeve sipas njoftimeve te kryera.

**14.5** Mbledhja e Asamblese zhvillohet mbi bazen e rendit te dites te njoftuar

**14.6** Te gjitha ceshtjet e rendit te dites shqyrtohen dhe ne perfundim, ceshtja hidhet ne ve otim. Per marrjen e vendimeve te vlefshme, aplikohen dispozitat perkatese ligjore qe rregullojne kuorumin e pjesemarrjes dhe vendimmarrjes ne mbledhje.

**14.7** Mbledhja e Asamblese mund te marre ne shqyrtim dhe te vendose per ceshtje te tjera jashte rendit te dites, te cilat mund te propozohen nga pjesemarresit ne mbledhje.

## Neni 15

### Procesverbali i mbledhjes se Asamblese

**15.1** Procesverbali eshte dokument qe mbahet gjate zhvillimit te mbledhjes ne te cilin fiksohen elementet thelbesore te saj.

**15.2** Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbslit, rezultatet e votimit.

**15.3** Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme

**15.4** Te gjitha vendimet e asamblese se pergjitshme duhet te regjistrohen ne procesverbal.

**15.6** Administratori i shoqerise eshte pergjegjes per mbajtjen e rregullt te procesverbaleve te mbledhjeve te Asamblese se pergjithshme , nenshkrimin e rregullt te tij, ruajtjen dhe venien ne dispozicion te personave te interesuar sipas ligjit.

**15.7** Nese shoqeria ka publikuar nje faqe ne internet , administratori , jo me vone se 15 dite nga data e mbedhjes, eshte i detyruar te publikoje kopje te procesverbalit te mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kete faqe

## PJESA V

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 16

### Administrimi i Shoqerise

**16.1** Administrimi i Shoqerise behet nga administrator ne perputhje me kompetencat, te drejtat dhe detyrimet qe i jep ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se pergjithshme dhe rregullat e brendshme te administrimit te Shoqerise.

**16.2** Administratori i shoqerise eshte:

1. **Z. Murat Gjeladini**, shtetas kosovare i datelindjes **11/04/1985**, lindur ne Peje dhe banues ne Tirane, identifikuar nga pasaporta nr. P**00175825** dhe nr. Personal **1170170233**, madhor ,m e zotesi te plote juridike per te vepruar.

E i cili ka keto kompetenca:

Te cilat kompetenca te ndara vetem per ceshtjet e meposhtme ku :

a. Eshte i autorizuar te perfaqesoje Shqiperine ne te gjitha ceshtjet qe kane lidhje me te, kundrejt paleve te treat dhe shtetin ;
b. Punesimin dhe shkarkimin e personelit te Shoqerise, percaktimin e pagave, shperblimeve dhe pagesave te tij
c. Marrjen e masave paraprake per mbrojtjen e interesave te Shoqerise , ngritjen e padive dhe marrjen persiper te mbrojtjes se Shoqerise ne rast te padive kunder saj ;
d. Udhezimin e avokateve/juristeve per mbrojtjen e interesave te Shoqerise dhe percaktimin e shumes se deshperblimit te tyre;

e. Ngritjen e padive dhe terheqjen e tyre, nenshkrimin e marreveshjeve gjyqesore, nenshkrimmin e marreveshjeve te arbitrazhit, caktimin e arbitrave;
f. Administrator ka te drejte te marre cdo vendim tjeter qe i takon aktivitetit te perditshem te Shoqerise nga pikepamja e ligjit dhe ketij Statuti
g. Thirrjen e Asamblese se pergjitshme, percaktimin e rendit te dites, monitorimine permbushjes se dipozitave qe kane lidhje me thirrjen dhe drejtimin e Asamblese se pergjithshme per shpalljen e vendimeve te vecanta;
h. Eshte pergjegjes per mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit te Shoqerise;
i. Administratori mund te autorizoje pale te treta qe ta perfaqesojne Shoqerine dhe marredheniet e saj te jashtme;
j. Administratori mund te autorizoje pale te treta qe ta perfaqesojne Shoqerine ne transaksione te vecanta qe jane ne kompetencen e tij;
k. Hapjen e llogarive bankare te Shoqerise prane bankave brenda dhe jashte vendit;
l. Dhenien me qira te aseteve te luajtshme dhe te paluajtshme te shoqerise;
m. Perfundimin e marreveshjeve mbi dhenien e huave pas marrjes se miratimit te Asamblese se Pergjithshme;
n. Perfundimin e marreveshjeve me palet e treat, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave;
o. Nenshkrimin e te gjithe dokumenteve, nxjerrjen e faturave, transferimet ne monedhe te huaj, flete-ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve te Shoqerise;
p. Mbledhjen e detyrimeve qe i takojne Shoqerise, dhenien dhe marrjen e paradhenieve;
q. Dhenien e njoftimit debitoreve te Shoqerise;
r. Eshte pergjegjes per mbajtjen e llogarive ne perputhje me ligjin;
s. Eshte pergjeges per pergatitjen e pasqyrave vjetore financiare te Shoqerise dhe kontrollin e tyre nga nje auditor i jashtem nese dicka e tille kerkohet nga ligji apo vendimi i Asamblese se Pergjithshme;
t. Publikimin e shpalljeve te nevojshme perfshire dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
u. Veprimet bankare te shoqerise, duke perfshire por pa u kufizuar ne to, hapjen dhe mbajtjen e llogarive bankare, transfertat bankare, terheqjen e shumave qe lidhen me aktivitetin e Shoqerise, duhet te behen me firmen e perbashket te Administratorit te Shoqerise dhe drejtuesit te structures qe mbulon veprimtarine financiare te Shoqerise;
v. Si dhe cdo veprim tjeter te nevojshem qe perfshin anen financiare te shoqerise pa perjashtuar edhe bankat.

**16.3** Administratori eshte pergjegjes per te gjitha veprimet e kryera prej tij perpara Shoqerise, ortakeve te saj, si dhe te treteve per demet qe mund t'u vijne atyre nga veprimet apo mosveprimet e tij qe vijne ne kundershtim me ligjin apo statutin, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

**16.4** Administratori ka kompetenca diskreciale per veprimet e perditshme te administrimit te Shoqerise. Ne kuptim te kesaj dispozite, Administratori mund te kryeje lirisht veprime te cilat ligji dhe Statuti nuk ia njohin ne menyre te shprehur Asamblese se pergjitshme, me kushtet qe:

a. Keto veprime te lidhen vetem me kompetencat e administrimit dhe jo te vendimmarrjes
b. Keto veprime te synojne **"G&M HOLDING SHPK"** lizimin e objektit te Shoqerise
c. Keto veprime te jene dhe te kryhen ne menyre te ligjshme.

**Neni 17**

**Raportimi i Administratorit**

**17.1** Administratori informon ortaket per ecurine e veprimtarise se Shoqerise dhe, me kerkesen e tij, sipas rastit dhe kompetencave perkatese parashikuar ne kete statut, duhet t'i vene ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se Shoqerise, raportet e ekspertit kontabel te autorizuar, si dhe cdo document tjeter te brendshem te Shoqerise, me perjashtim te atyre te percaktuar me ligj. Ky detyrim mund te permbushet edhe duke e vendosur kete informacion ne faqen e internetit te Shoqerise dhe duke informuar per kete personat, te cilet e bejne kerkesen. Ne te kundert , keto dokumente duhet te vihen ne dispozicion, per shqyrtim, prane selise se Shoqerise

**Neni 18**

**Kohezgjatje e mandatit**

**18.1** Administratoret emerohen me vendim te Asamblese se ortakeve, per nje periudhe kohore

Jo me shume se 5 (pese) to me te drejte riemerimi.

**18.2** Ne rast doreheqje/ shkarkimi, Asambleja e pergjithshme emeron me vendim Administratorin e ri te Shoqerise jo me vone se 2 jave nga moment I njoftimit te doreheqjes ose shkarkimit.

**18.3** Akt i emerimit permban domosdoshmerisht edhe kohezgjatjen e mandatit te Administratorit

**Neni 19**

**Shkarkimi i Administratorit**

**19.1** Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

**19.2** Me aktin e shkarkimit, Administratori nderpret menjehere marredheniet administrative me shoqerine. Qe nga momenti i shkarkimit, Administratori nuk ka me te drejte te nenshkruaje ne emer te shoqerise, dhe as te kryeje veprime te tjera administrimi.

**19.3** Akt i shkarkimit nuk mund te pezullohet per asnje shkak. Ai ekzekutohet menjehere.

**19.4** Administratori qe largohet nga detyra ka te drejte t'i drejtohet Gjykates kompetente per pretendime te mundshme te tij sipas legjislacionit ne fuqi.

**PJESA IV**

**VITI FINANCIAR, BILANCI, ADMINISTRIMI I FITIMIT**

**Neni 20**

**Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

**20.1** Viti financiar i Shoqerise zgjate 12 muaj. Ai fillon ne diten e pare te muajit Janar dhe mbaron ne diten e tridhjete e nje te muajit Dhjetor.

**20.2** Ne fund te cdo viti financiar, Administratori do te permbushe detyrat e meposhtme:

a. Pergatitjen e nje liste te detajuar te aseteve te Shoqerise dhe struktures se tyre;
b. Pergatitjen e bilancit te Shoqerise i cili pershkruan situaten financiare te Shoqerise;
c. Pergatitjen e llogarive te fitimit dhe te humbjeve

**20.3** Pasqyrat financiare te pergatitura do te paraqiten ne mbledhjen e Asamblese se pergjithshme per miratim se bashku me nje raport te auditoreve te jashtem, nese ka, sipas legjislacionit tatimor ne fuqi.

**20.4 Drejtuesi** i structures financiare dhe llogaritari kryesor i Shoqerise do te sigurojne zbatimin e pervitshem te auditimit te jashtem te Shoqerise, si dhe gjendjen e duhur te librave te llogarise e te dokumenteve te tjera, qe pasqyrojne ne menyre te vertete gjendjen financiare te Shoqerise dhe rezultatet e veprimtarise se saj ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS).

**Neni 21**

**Fitimi i Shoqerise**

**21.1** Fitimi neto do te jete fitimi i Shoqerise ne perputhje me pasqyrat vjetore financiare te miratuara pas zbritjes se te gjitha tatimeve dhe caktimit te rezervave ligjore.

## PJESA VII

## NDRYSHIMI I KAPITALIT DHE EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

**Neni 22**

**Modalitetet e zmadhimit te kapitalit**

**22.1** Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te kuotave te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te kuotave ekzistuese

**22.2** Kuotat e reja shlyhen me para ne dore , me kompensim te nje kredie ne para te kerkueshme dhe te detyruar per t'u shlyer nga shoqeria, me perfshirje te rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit, me ne natyre etj.

**22.3** Ne rastin e kontributeve ne natyre, vleresimi i tyre behet prej nje ose me shume eksperteve per kontributet te zgjedhur nga Asambleja ose te caktuar me vendim nga Gjykata ne baze te kerkeses se bere nga Administratori i Shoqerise.

**Neni 23**

**Modalitetet e zvogelimit te kapitalit**

**23.1** Zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejten mase ne perjashtim me vleren e kuotave qe zoterojne

**23.2** Projekti i zvogelimit te kapitalit komunikohet prej ekspertit kontabel te autorizuar, te pakten 45 dite kalendarike perpara mbledhjes se Asamblese se pergjithshme qe thirret per te vendosur mbi kete project

**23.3** Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertit kontabel te autorizuar, i cili jep vleresimin e tij mbi shkaqet dhe kushtet e zvogelimit.

**Neni 24**

**Ushtrimi I kontrollit nga ekspertet kontabel te autorizuar**

**24.1** Kontrolli i Shoqerise ushtrohet nga nje ekspert kontabel te autorizuar i cili emerohet nga Asambleja e pergjithshme.

**Neni 25**

**Kohezgjatja e mandatit dhe zevendesimi**

**25.1** Eksperti kontabel i autorizuar emerohet per nje vit financiar. Funksionet e tij perfundojne pas mbledhjes se Asamblese se pergjithshme e cila merr vendim mbi llogarite vjetore.

**25.2** Eksperti kontabel i autorizuar, i emeruar nga Asambleja e pergjithshme per zevendesimin e nje tjetri, mbetet ne funksion deri ne fundin e mandatit te paraardhesit te tij.

**Neni 26**

**Detyra e ekspertit**

**26.1** Eksperti ka per detyre te perhershme, duke perjashtuar cdo nderhyrje ne administrim, te verifikoje librat e llogarise dhe fondet e Shoqerise si dhe te kontrolloje pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi. Ai verifikon gjithashtu vertetesine dhe perputhjen me llogarite vjetore te informacioneve te dhena ne raportin e administrimit nga ana e Administratorit dhe ne dokumentet qe u jane derguar ortakeve mbi gjendjen financiare dhe llogarite vjetore.

**Neni 27**

**Pergjegjesia**

**27.1** Eksperti kontabel i autorizuar eshte pergjegjes si ndaj Shoqerise, ashtu dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet e tij ne ushtrimin e funksioneve perkatese.

**27.2** Ai nuk eshte ligjerisht pergjegjes per shkeljet e ligjit te kryera nga Administratori, me perjashtim te rasteve kur ka pasur dijeni per to, por nuk i ka zbuluar ne raportin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

**PJESA VIII**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

**Neni 28**

**Prishja dhe likuidimi**

**28.1** Shoqeria do te prishet ne rastet e parashikuar ne ligj, si dhe ne rastet kur prishja diktohet nga riorganizimi i Shoqerise ne nje nga format e parashikuara ne ligj.

**28.2** Likuidimi i Shoqerise dhe shperndarja e aseteve te Shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat ligjore ne momentin e fillimit te procedures se likuidimit.

**PJESA IX**

**TE PERGJITHSHME**

**Neni 29**

**Te pergjithshme**

**29.1** Ky statut hartohet dhe miratohet ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale, te cilat depozitohen ne organet kompetente, ruhen ne seline e Shoqerise dhe i njoftohet ortakut.

**29.2** Te gjitha ceshtjet per te cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon ne menyre te posacme, do te rregullohen sipas dispozitave te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe legjislacionit tjeter ne fuqi qe parashikon menyren e organizimit, funksionimit dhe kontrollit te shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

**Miratohet sot me date 21/09/2020, ne qytetin e Tiranes, dhe nenshkruhet nga Ortaku i vetem:**

**z. Murat Gjeladini**

**Firma:**

______________________

**Administratori:**

**z. Murat Gjeladini**

**Firma:**

______________________